


NJOFTIM PËR QIRAMARRËSIT:

Nëse keni humbur të ardhura ose keni pasur rritje të kostove gjatë pandemisë së COVID-19 ose nëse shpërngulja do të përbente rrezik serioz për shëndetin tuaj, apo të një pjesëtari të familjes për shkak të rrezikut të shtuar për sëmundje të rëndë ose vdekje nga COVID-19, si pasojë e një problemi të mëparshëm shëndetësor dhe nëse e nënshkruani dhe nëse ia dorëzoni këtë formular të deklaratës së vështirësisë qiradhënësit tuaj, ju nuk mund të dëboheni nga banesa të paktën deri më 31 gusht 2021 për mospagim të qirasë ose zënie të pronës pas përfundimit të kontratës suaj të qirasë. Gjithsesi, ju mund të dëboheni nga banesa për shkelje të kontratës suaj të qirasë, nëse keni sjellje që cenon ndjeshëm në mënyrë të vazhdueshme dhe të paarsyeshme përdorimin ose prishni qetësinë e qiramarrësve ose banorëve të tjerë ose rrezikoni në mënyrë të konsiderueshme sigurinë e të tjerëve.

Nëse qiradhënësi juaj ju ka dhënë këtë formular, ai/ajo gjithashtu duhet t'ju jape një adresë postare dhe email se ku duhet ta ktheni këtë formular. Nëse qiradhënësi juaj tashmë ka filluar procedurat për dëbimin tuaj, ju mund ta ktheni këtë formular ose tek pronari ose në gjykatë ose tek të dy në çdo moment. Mbani një kopje ose foto të deklaratës suaj. Ju, gjithsesi, i detyroheni pronarit tuaj çdo shumë të qirasë së papaguar. Ju gjithashtu duhet të mbani shenim për të gjitha pagesat që keni bërë si dhe çdo shumë tjetër që duhet të paguani.

Për më shumë informacione rreth burimeve ligjore që mund të jenë në dispozicionin tuaj, vizitoni faqen www.nycourts.gov/evictions/nyc/ ose, nëse jetoni në qytetin e Nju Jorkut, telefononi në nr. 718-557-1379, ose vizitoni faqen www.nycourts.gov/evictions/outside-nyc/ ose, nëse jetoni jashtë qytetit të Nju Jorkut, telefononi dhomën lokale të avokatisë ose ofruesit e shërbimeve ligjore. Asistenca e qirasë mund të jetë e disponueshme për ju dhe duhet të kontaktoni zyrën tuaj lokale të asistencës së strehimit.



Index Number (if known/applicable): _____

County and Court (if known/applicable): _____

DEKLARATA E VËSHTIRËSISË SË QIRAMARRËSIT GJATË PANDEMISË SË COVID-19

Unë jam një qiramarrës, banor i ligjshëm, ose dikush tjetër përgjegjës për pagimin e qirasë, përdorimin dhe shfrytëzimin ose për ndonjë detyrim tjetër financiar sipas një kontrate afatgjate dhe afatshkurte qiraje në (adresa e njësisë së banimit).

JU DUHET TË TREGONI MË POSHTË NËSE KUALIFIKOHENI PËR MBROJTE NGA DËBIMI I BANESËS, DUKE ZGJEDHUR OPSIONIN “A” OSE “B” OSE TË DYJA.

- A. Unë ndodhem në vështirësi financiare dhe nuk jam në gjendje të paguaj shumën e plotë të qirasë sime ose detyrime të tjera financiare sipas kontratës së qirasë ose të përfitoj strehim të përhershëm e të përshtatshëm alternativ për shkak të një ose më shumë arsyeve të mëposhtme:
1. Humbje të konsiderueshme të të ardhurave për shkak të pandemisë së COVID-19.
 2. Rritje të shpenzimeve të nevojshme nga xhepi në lidhje me kryerjen e një pune thelbësore ose me ndikimet shëndetësore gjatë pandemisë së COVID-19.
 3. Përgjegjësitë ndaj kujdesit të fëmijëve ose një të moshuari, ndaj dikujt me aftësi të kufizuara ose një pjesëtar të sëmurë të familjes gjatë pandemisë së COVID-19 kanë ndikuar negativisht në aftësinë time ose aftësinë e dikujt në familjen time për të gjetur një punë të përshtatshme ose për të fituar të ardhura ose kanë rritur shpenzimet e mia të nevojshme nga xhepi.

4. Shpenzimet e shpërnguljes dhe vështirësitë që kam për të siguruar strehimin alternativ e bëjnë të vështirë që unë të shpërngulem në një banesë tjetër gjatë pandemisë së COVID-19.
5. Rrethana të tjera në lidhje me pandeminë e COVID-19 kanë ndikuar negativisht në aftësinë time për të gjetur një punë të përshtatshme ose për të fituar të ardhura ose i kanë ulur ndjeshëm të ardhurat e familjes sime ose i kanë rritur ndjeshëm shpenzimet e mia.

Deri në masën që kam humbur të ardhurat familjare ose kam rritur shpenzimet, çdo asistencë sociale, përfshirë pagesën e përkohshme të papunësisë, atë të papunësisë për shkak të pandemisë, pagesës së aftësisë së kufizuar ose lejes familjare me pagesë, që kam marrë që nga fillimi i pandemisë së COVID-19 nuk e kompenson plotësisht humbjen time të të ardhurave familjare ose shpenzimet e shtuara.

- B. Lënia e banesës dhe shpërngulja në një banesë të re të përhershme do të përbente rrezik serioz shëndetësor, sepse unë ose një ose më shumë pjesëtarë të familjes sime jemi nën rrezik të shtuar nga sëmundje të rënda ose vdekje nga COVID-19 për shkak të moshës mbi gjashtëdhjetë e pesë vjeç, të një aftësie të kufizuar ose problemi shëndetësor të mëparshëm, që mund të përfshijë edhe, por nuk kufizohet me dëmtim të sistemit imunitar.

Unë e kuptoj se duhet të veproj në përputhje me të gjitha kushtet e tjera ligjore sipas rregullave të qiramarrjes, marrëveshjes së qirasë, ose marrëveshje të ngjashme. Unë e kuptoj më tej se tarifat e ligjshme, gjrobat ose interesat për të mos e paguar plotësisht qiranë ose për të përmbushur detyrime të tjera financiare siç kërkohet nga rregullat dhe kushtet e përgjithshme, marrëveshja e qirasë ose një kontratë e ngjashme mund jenë të detyrueshme ose të mbledhura dhe mund të ndodhë që të lëshohet një urdhër gjykate për pagesë kundër meje. Unë e kuptoj më tej se qiradhënësi im mund të jetë në gjendje të kërkojë dëbimin nga banesa pas datës 31 gusht 2021, dhe se ligji mund të sigurojë mbrojtje të caktuara në atë kohë që janë të ndara nga ato të shprehura në këtë deklaratë.

Nënshkroi: _____

Emri i plotë me shkronja shtypi: _____

Data e nënshkrimit: _____

NJOFTIM: Ju po e nënshkruani dhe e dorëzoni këtë formular nën përgjegjësi ligjore. Kjo nënkupton se deklarami i fakteve në këtë formular për të cilat jeni në dijeni se janë të rreme, përbën shkelje të ligjit.